

# Financimi i pushteteve lokale në veri të Kosovës – vallja pa ndalim

Dragiša Mijacic  
Jovana Jakovljevic  
dr Vesela Vlaskovic <sup>1</sup>

Korrik 2017

*Ky dokument për politika është shkruar në kuadër të projektit të financuar përmes granteve të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, qëndrimet, konkludimet apo mesazhet që gjenden në tekst janë të autorëve dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht qëndrimet e Departamentit të Shtetit.*

## 1. Hyrje

Komunat në veri të Kosovës janë bërë shfrytëzues buxhetorë vetëm pas zgjedhjeve lokale dhe konstituimit të organeve lokale të pushtetit. Megjithatë, procesi i financimit të pushteteve lokale në veri të Kosovës përcillet me një numër sfidash që janë karakteristike edhe për segmente të tjera të funksionimit të këtyre komunave.

Qëllimi i këtij punimi është të prezantojë kornizën ligjore që rregullon procesin e përgatitjes, paraqitjes dhe miratimit të buxhetit komunal, si dhe të prezantojë sfidat kryesore në procesin e realizimit të buxhetit në komunat e veriut të Kosovës.

## 2. Sistemi i financimit të komunave në Kosovë

Financimi i komunave në Kosovë rregullohet me Ligjin për vetë-qeverisje lokale,<sup>2</sup> Ligjin për financat e pushtetit lokal<sup>3</sup> si dhe Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.<sup>4</sup> Me rastin e hartimit të këtyre ligjeve, janë konsultuar Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale të Këshillit të Evropës, e cila në nenin 9 të saj parasheh që komunat duhet të kenë mjete të mjaftueshme financiare për realizim të suksesshëm të kompetencave të dhëna.<sup>5</sup>

Me Ligjin për vetëqeverisje lokale janë definuar kompetencat komunale, që mund të jenë vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara.<sup>6</sup> Në anën tjetër, Ligji për financat e pushtetit lokal

<sup>1</sup> Të gjitha të drejtat i përkasin ©InTER2017. Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni në adresën: office@regionalnirazvoj.org.

<sup>2</sup> Ligji nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, gjendet tek <http://bit.ly/2tyqufg>

<sup>3</sup> Ligji nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, gjendet tek <http://bit.ly/2uO271h>. Ligji nr. 05/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji gjendet tek <http://bit.ly/2tsHLLa>.

<sup>4</sup> Ligji nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, gjendet tek <http://bit.ly/2tH9BSs>. Ndryshimet e fundit të këtij ligji: Ligji nr.05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221, 04/L-116 si dhe nr. 04/L-194, gjenden tek <http://bit.ly/2uOxetA>

<sup>5</sup> Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale e Këshillit të Evropës, gjendet tek <http://bit.ly/2vOse5b>

<sup>6</sup> Kompetencat e zgjeruara përcaktohen me nenet 19, 20, 21, 22 dhe 23 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, si dhe kanë të bëjnë me kompetencat në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe kulturës, si dhe të drejtat e pjesëmarrjes



parasheh që Kuvendi, Qeveria dhe ministritë e linjës duhet të sigurojnë mjetet buxhetore të domosdoshme për përmbushjen e kompetencave të komunave. Neni 7 i këtij Ligji përcakton edhe burimet e financimit të komunave, të cilët përbëhen nga:

- 1) Të ardhurat vetanake, të parapara me nenin 8 të këtij ligji;
- 2) Grantet operationale;
- 3) Grantet për kompetencat e zgjeruara;
- 4) Transferet për kompetenca të deleguara;
- 5) Grantet e jashtëzakonshme;
- 6) Ndihma financiare nga Republika e Serbisë;
- 7) Të ardhurat nga taksat komunale.

Të ardhurat vetanake të komunave janë paraparë me nenin 8 të të njëjtit ligj, si dhe përbëhen nga këto:

- 1) Taksat, tarifat komunale, pagesat/tarifat e shfrytëzimit, pagesa të tjera për shërbime publike që sigurohen nga komuna, si dhe pagesat rregullative dhe gjobat që miratohen në bazë të këtij ligji;
- 2) Të ardhurat nga dhënia me qira e pronave të paluajtshme që gjenden në komunë, si dhe që administrohen apo janë në pronësi të komunës;
- 3) Të ardhurat nga shitja e aseteve komunale;
- 4) Të ardhurat nga ndërmarrjet që janë plotësisht apo pjesërisht në pronësi të komunës;
- 5) Participimi nga ana e shfrytëzuesve të shërbimeve arsimore dhe shëndetësore që ofrohen nga komuna;
- 6) Të ardhurat që realizohen nga ndonjë organ/agjenci, drejtori (departament) apo organizatë e komunës, si pasojë e ofrimit të mallrave apo shërbimeve;
- 7) Interesat mbi investimet komunale, nëse ka të tilla;
- 8) Grantet dhe/ose donacionet nga qeveritë e huaja (përveç ndihmës financiare nga Republika e Serbisë) apo nga organizatat e huaja, duke përfshirë organizatat qeveritare dhe joqeveritare si dhe institucionet ndërkombëtare dhe supranacionale;
- 9) Të gjitha kategoritë tjera të të ardhurave që përcaktohen si të ardhura vetanake komunale në bazë të ligjit.

Me këtë ligj është paraparë që edhe komunat të pranojnë mjete operationale nga buxheti qendror (neni 23), derisa këto përfshijnë mjetet e përgjithshme operationale, mjetet operationale të caktuara për arsim, si dhe mjetet operationale për shërbime shëndetësore. Këto mjete do të duheshin ndarë në bazë të kriterëve të drejta, transparente e objektive, duke i dhënë komunave liri më të madhe të ndarjes dhe shpenzimit të këtyre granteve.

Kushtet për financimin e katër komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës (Mitrovica e Mitrovica e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq) janë krijuar vetëm pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit, organizimit të zgjedhjeve lokale dhe konstituimit të organeve komunale (Kuvendi Komunal dhe Kryetari i Komunës). Vetëm pas përfundimit të këtij procesi, komunat iu janë qasur procesit të hartimit të buxhetit, për të cilën gjë do të flitet më vonë në këtë punim.

Kur bëhet fjalë për financimin e komunave në veri të Kosovës, është me rëndësi të përmendet edhe Fondi për Zhvillimin e Komunave Veriore, që është themeluar si pasojë e Marrëveshjes për Doganat, të arritur në kuadër të dialogut të Brukselit. Pra, me këtë marrëveshje është paraparë formimi i Fondit për Zhvillimin e Komunave Veriore (i quajtur Fondi Doganor) nga të ardhurat doganore që mblidhen tek porta 1 (Jarinje) dhe 31 (Brnjak), nga zhdoganimi i mallrave që janë të synuara për veriun e Kosovës, si dhe nga zhdoganimi i mallrave të ndërmarrjeve që janë të regjistruara në katër komunat në veri të Kosovës. Mjetet e këtij Fondi mund të përdoren ekskluzivisht nga katër komunat e veriut të Kosovës, si dhe vetëm për projektet e tyre zhvillimore, si ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës publike (që përfshin rrugët, spitalet, ujësjellësin, trajtimin e ujërave të zeza dhe menaxhimin e mbeturinave), mbështetja e ndërmarrjeve, bujqve dhe shoqërisë civile, promovimi i të drejtave të njeriut, arsimit, qasja në shërbime shëndetësore dhe transport.

### 3. Procesi i hartimit të buxhetit komunal

#### 3.1 Procedurat dhe afatet për hartimin e buxhetit të komunave

Ligji për alokimet vjetore rregullon alokimet për të gjitha organizatat buxhetore, duke përfshirë komunat, si dhe iu jep atyre autorizime për të shpenzuar apo bartur fondet publike deri në një shumë të caktuar dhe për destinomë të caktuara, brenda një viti fiskal.

Procesi i hartimit të buxhetit komunal fillon me hartimin e kornizës afatmesme buxhetore komunale (më tutje në tekst: Korniza afatmesme). Ky është dokument që miratohet çdo vit nga Kuvendi Komunal, përfshin elemente për tri vite fiskale në vijim, si dhe ofron një analizë të detajuar të të ardhurave dhe shpenzimeve komunale. Shpenzimet planifikohen me qëllim të realizimit të prioriteteve strategjike për zhvillimin social e ekonomik të komunës. Korniza afatmesme paraqet një mekanizëm të dobishëm me anë të të cilit prioritetet strategjike të komunës mund të integrohen më mirë brenda procesit buxhetor. Secila komunë është e obliguar të hartojë Kornizën afatmesme, gjë që kërkohet përmes qarkoreve vjetore për hartimin e buxheteve komunale (më tutje në tekst: Qarkore buxhetore), që nxirren nga Ministria e Financave

Në hartimin e Kornizës afatmesme dhe buxhetit komunal, rolin dhe përgjegjësinë më të rëndësishme e marrin kryetari i komunës dhe Kuvendi Komunal. Kryetari është përgjegjës për hartimin e buxhetit, i cili i dorëzohet Kuvendit Komunal për miratim. Pas miratimit të buxhetit, Kryetari është përgjegjës edhe për ekzekutimin e tij.<sup>7</sup> Në nivel të Kuvendit të Komunës, Komiteti për Politikë e Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha dokumenteve financiare e fiskale, e me këtë edhe për shqyrtimin e propozim-buxhetit.<sup>8</sup> Komentet e veta mund t'i japë edhe Komiteti për Komunitete, i cili ka të drejtë të japë mendime këshilluese në lidhje me alokimet për komunitetet jo-shumicë në komuna. Pas kësaj, të dy dokumentet dërgohen për miratim tek Kuvendi i Komunës, si organi më i lartë përfaqësues i komunës. Gjatë hartimit (apo edhe ekzekutimit) të buxhetit, komuna mund të konsultohet me Departamentin për Buxhete Komunale në Ministrinë e Financave, i cili është i obliguar të ofrojë ndihmë për komunat në këto çështje.

Ekzistojnë disa hapa konkretë që duhen respektuar gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të Kornizës Afatmesme dhe buxhetit vjetor komunal. Këta hapa janë të përshkruar në qarkoren buxhetore që nxirret nga Ministria e Financave. Qarkorja buxhetore është dokumenti themelor për planifikimin e buxhetit komunal, si dhe përmban udhëzime për hartimin e tij. Ky dokument jep udhëzimet, afatet kohore dhe kufizimet fillestare financiare për nevojat e hartimit të buxhetit komunal dhe projeksioneve për tri vitet fiskale në vijim.

Gjatë hartimit të buxhetit, ekzistojnë afate që duhen respektuar, e që caktohen me datat vijuese:

30 prill	Procesi i hartimit të buxhetit fillon me faktin që Qeveria e Kosovës është e obliguar që deri më 30 prill të çdo viti kalendarik t'i dorëzojë Kornizën Afatmesme <sup>9</sup> Kuvendit të Kosovës për miratim, kornizë kjo që përfshin vitin vijues fiskal dhe projeksionet për dy vitet fiskale në vijim. <sup>10</sup>
15 maj	Afati në të cilin Ministri i Financave duhet të nxjerrë Qarkoren e parë Buxhetore për drejtoritë komunale për financa. <sup>11</sup>
30 qershor	Afati brenda të cilit Kuvendet Komunale duhet të shqyrtojnë, ndryshojnë e miratojnë Kornizën Afatmesme komunale, e cila i duhet dorëzuar Ministrisë së Financave dhe të vihet në dispozicion të publikut. Gjatë hartimit të Kornizës Afatmesme, pushteti lokal do të duhej të konsultohet me palët kryesore të interesit në komunitete, ku me anë të dëgjimeve publike e me mekanizma të tjerë (anketa, takime të drejtpërdrejta, etj.) duhet biseduar për prioritetet e komunës. Para miratimit të këtij dokumenti, Komiteti për Politikë e Financa gjithashtu do të duhej të organizonte

<sup>7</sup> Neni 58, Ligji nr. 03/L – 040 për vetëqeverisje lokale, gjendet tek <http://bit.ly/2tyqufg>

<sup>8</sup> Neni 52.2, Ligji nr.03/L – 040 për vetëqeverisje lokale, gjendet tek <http://bit.ly/2tyqufg>

<sup>9</sup> Përmbajtja e Kornizës Afatmesme është dhënë me nenin 19 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

<sup>10</sup> Neni 5, Ligji nr. 03/L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, gjendet tek <http://bit.ly/2tM8NM9>

<sup>11</sup> Neni 6.2, Ligji nr. 03/L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, gjendet tek <http://bit.ly/2tM8NM9>

dëgjime publike, në të cilat do të duheshin shqyrtuar e diskutuar prioritetet strategjike të komunës.<sup>12</sup>

- 15 gusht Afati brenda të cilit Ministri i Financave nxjerr qarkoren e dytë buxhetore, me të cilën jepen udhëzimet përfundimtare buxhetore me shumat përfundimtare të transferove buxhetore, të llogaritura në pajtim me Ligjin për financat e pushtetit lokal, si dhe në pajtim me propozimet nga Korniza Afatmesm.
- 1 shtator Afati brenda të cilit Kryetari i Komunës duhet të dorëzojë propozim-buxhetin komunal tek Kuvendi Komunal për shqyrtim dhe miratim. Propozim-Buxheti komunal duhet të përmbajë këta kapituj: projeksionet ekonomike dhe buxhetore dhe supozimet; vlerësimin e përgjithshëm të të gjitha burimeve; vlerësimin e shpenzimeve të përgjithshme në të gjitha kategoritë e shpenzimeve; vlerësimin e mbështetjes së pritur nga donatorët; si dhe të gjitha informatat tjera me rëndësi esenciale për buxhetin.<sup>13</sup> Nëse Kryetari i Komunës nuk e përmbush këtë obligim brenda afatit të përcaktuar me ligj, Qeveria vendos sanksione ndaj komunës, të cilat përfshijnë edhe emërimin e administratorit financiar që merr përsipër nga kryetari të gjitha kompetencat në këtë fushë.<sup>14</sup>
- 30 shtator Kuvendet Komunale duhet të shqyrtojnë, e sipas nevojës edhe të ndryshojnë, të aprovojnë e miratojnë buxhetin komunal për vitin vijues, i cili duhet t'i dorëzohet Ministrisë së Financave deri më 30 shtator. Me propozim-buxhetin, komunat i dorëzojnë Ministrisë edhe kërkesën për ndarjen e mjeteve.<sup>15</sup> Nëse Kuvendi Komunal nuk e miraton propozim-buxhetin brenda afatit të përcaktuar me ligj, Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal mund të marrë masën e shpërndarjes së kuvendit dhe vendosjen e masave të përkohshme.<sup>16</sup>

Pra, gjatë hartimit të buxhetit, komunat janë të obliguara t'i dorëzojnë Ministrisë së Financave dy dokumente kryesore. Dokumenti i parë është Korniza Afatmesme, të cilën së pari e miraton Komiteti për Politikë e Financa, si dhe duhet t'i dorëzohet Ministrisë së Financave deri më 30 qershor. Dokumenti i dytë është propozim-buxheti komunal vjetor, të cilin Kryetari i Komunës ia dorëzon Komitetit për Politikë e Financa si dhe Kuvendit Komunal deri më 1 shtator, ku miratohet me shumicë votash, si dhe i dërgohet Ministrisë së Financave deri më 30 shtator. Kur propozim-buxheti i miratuar i dorëzohet Ministrisë së Financave, ajo e bën verifikimin nëse buxheti është në pajtim me qarkoren buxhetore, si dhe pas kësaj, në afat prej tetë ditësh, njofton komunat nëse buxheti i tyre është miratuar, apo ka nevojë të bëhen ndryshime.

### 3.2 Pjesëmarrja e qytetarëve në hartimin e propozim-buxhetit

Procesi i hartimit të Kornizës Afatmesme dhe buxhetit vjetor komunal parasheh mundësinë e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve. Qytetarët kanë mundësi ligjore që të kërkojnë ndryshimin e kategorive të caktuara buxhetore dhe ndarjeve të mjeteve buxhetore, ndërsa vendimin për pranimin apo refuzimin e propozimeve të tilla e merr Kryetari i Komunës. Qytetarët gjithashtu mund të marrin pjesë në seancat e Komitetit për Politikë e Financa apo seancat e Kuvendit Komunal, ku mund të parashtrojnë propozime për financimin e projekteve të interesit të përgjithshëm. Sipas Ligjit për për vetëqeverisje lokale, seancat e Kuvendit Komunal dhe komiteteve të tij janë të hapura për publikun. Përveç kësaj, ligji e obligon Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin Komunal që të organizojnë shqyrtime publike të dokumenteve me rëndësi të posaçme për qytetarë. Në këto takime, organet e pushtetit lokal janë të obliguara të informojnë qytetarët për planet apo programet e veta me rëndësi publike, mes të cilave bën pjesë edhe propozim-buxheti. Sipas të dhënave të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, gjatë vitit 2016, komuna e Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit dhe Zveçanit nuk kanë mbajtur asnjë dëgjim publik me qytetarë në lidhje me çështjet buxhetore.<sup>17</sup>

<sup>12</sup> Qarkorja buxhetore 2016/01 për komunat, Ministria e Financave, gjendet tek <http://bit.ly/2tQilEZ>

<sup>13</sup> Neni 61.1, Ligji nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, gjendet tek <http://bit.ly/2tH9BSs>

<sup>14</sup> Neni 62, Ligji nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, gjendet tek <http://bit.ly/2tH9BSs>

<sup>15</sup> Neni 20.3, Ligji nr. 03/L – 048 o upravljanju i odgovornostima za rad u javnim finansijama, gjendet tek <http://bit.ly/2tH9BSs>


<sup>16</sup> Neni 50.2 Ligji nr.03/L – 040 për vetëqeverisje lokale, gjendet tek <http://bit.ly/2tyqufg>

<sup>17</sup> Raporti mbi funksionimin e komunave të Republikës së Kosovës, periudha janar-dhjetor 2016, gjendet tek <http://bit.ly/2rC0zXq>

### 3.3 Analiza e buxheteve të komunave në veri të Kosovës për vitin 2016

Në vitin 2016, komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës kanë pasur në dispozicion buxhete në këto shuma: Mitrovica e Veriut - 6.771.782 Euro, Zveçani 2.788.498 Euro, Zubin Potoku 2.459.026 Euro, si dhe Leposaviqi 4.227.337 Euro. Këto komuna në mënyra të ndryshme kanë ndarë mjetet buxhetore në kategori, gjë që mund të shihet qartë në grafikun 1.

**Grafiku 1. Ndarja e mjeteve buxhetore në kategori në komunat e veriut të Kosovës, për vitin 2016**



*Burimi: Raporti i auditimit të pasqyrave financiare vjetore të komunave Mitrovica e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016.*

Nga grafiku mund të shihet që komuna e Zveçanit ka ndarë më së shumti mjete për investime kapitale (72,2%), më së shumti janë ndarë për paga e mëditje në komunën Zubin Potok (30%), derisa më së shumti mjete janë ndarë për mallra e shërbime në Mitrovicën e Veriut (14%). Shërbimet komunale në të gjitha komunat janë nën shifrën prej 1% të buxhetit, derisa shumat e subvencioneve e transfertave shkojnë nga 2,7% në Zveçan në 1,6% në Zubin Potok.

#### 4. Raportet vjetore financiare dhe të auditimit

Pas ekzekutimit të buxhetit, komunat janë të obliguara të përgatisin dhe të dorëzojnë raportin vjetor financiar. Ky raport i dorëzohet drejtorit të përgjithshëm të Thesarit<sup>18</sup>, derisa afati i dorëzimit është 30 nga përmbyllja e vitit fiskal. Për dorëzim të raportit vjetor financiar janë të obliguar zyrtari kryesor financiar dhe zyrtari kryesor administrativ në

<sup>18</sup> Departamenti i Thesarit ("Thesari") është themeluar në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, si dhe është përgjegjës për menaxhimin e Fondit të Konsoliduar të Kosovës, si dhe për përmbushjen e detyrimeve të tjera të përcaktuara me ligj

komunë.<sup>19</sup> Raporti i dorëzohet edhe Zyrës Kombëtare të Auditimit<sup>20</sup> e cila bën auditimin vjetor të rregullsisë së buxhetit të Kosovës dhe organizatave buxhetore (në këtë rast komunës) në pajtim me ligjin.

Auditimi i buxheteve komunale bëhet çdo vit për të vërtetuar nëse buxhetet janë menaxhuar në mënyrën e duhur, ekonomike dhe efikase, si dhe nëse ekzistojnë sisteme për matjen e efikasitetit të tyre. Në komunat e veriut të Kosovës, raportet e auditimit të buxheteve komunale hartohen nga fillimi i vitit 2014, derisa raporti për vitin buxhetor 2016 është publikuar në qershor të këtij viti.

Në gjetjet e raporteve të auditimit për komunat në veri të Kosovës, thuhet që planifikimi i buxhetit është joadekuat, si dhe që realizimi i tij është në nivel të ulët. Për shembull, komuna e Zveçanit gjatë vitit 2016 ka shfrytëzuar vetëm 58% të mjeteve të disponueshëm buxhetore.<sup>21</sup> Megjithatë, edhe përkundër realizimit të dobët të buxhetit, në raporte theksohet përmirësimi në krahasim me vitin 2015, gjë që tregon trendin pozitiv në përforsimin e kapaciteteve komunale në realizim të buxhetit.

Auditorët kanë gjetur që në komunat e veriut të Kosovës nuk ekzistojnë strategji zhvillimore<sup>22</sup> dhe plane të tjera zhvillimore. Mungesa e strategjisë së zhvillimit të përgjithshëm dhe planeve të tjera zhvillimore e bën të pamundur përcjelljen dhe matjen e përmirësimit të synimeve afatgjate dhe afatshkurtra. Kështu, në raport theksohet rekomandimi i auditorit për kryetarët e komunave të veprojnë në hartimin e strategjisë zhvillimore dhe hartimin e planit të veprimit, ashtu që të mund të përcillet përmirësimi buxhetore e qëllimeve dhe prioritetet e komunave.

Për komunat në veri të Kosovës, procesi i prokurimit publik është ende sfidë e madhe, për shkak të ndërlikueshmërisë së zbatimit të kërkesave në Kosovë. Kështu, shpesh ndodh që projektet të mos realizohen në vitin buxhetor në të cilin është planifikuar ekzekutimi i tyre, kështu që mjetet dhe aktivitetet e mbetura barten në vitin vijues, për ç'gjë kërkohet pëlqimi i posaçëm i Ministrisë së Financave. Në raportet e auditimit theksohet që edhe përkundër rritjes së buxhetit për investime kapitale, realizimi i mjeteve të tilla është ende në nivel të dobët.<sup>23</sup>

Gjetje e përbashkët në raportet e auditimit për të katër komunat e vëzhguara është edhe fakti që komunat mbledhin tepër pak të ardhura vetanake. Në buxhetet komunale, të ardhurat vetanake ndahen në tri kategori: të ardhurat e mbledhura nga ana e komunës, gjobot policore, si dhe gjobot gjyqësore.

Sipas raportit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, komunat Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq kanë inkasuar nën 10% të të ardhurave të parapara vetanake të drejtpërdrejta. Sa i përket inkasimit të të ardhurave vetanake, komunat e veriut të Kosovës thirren në vendime të kohës së UNMIK-ut, të cilat nuk parashohin të ardhura nga tatimi në qarkullim dhe pronë, lejet e ndërtimit, shfrytëzimi i pronës publike apo burimet tjera të të ardhurave komunale sipas legjislacionit kosovar. Kështu, të gjitha mjetet e inkasuara në këtë linjë buxhetore i përkasin të ardhurave nga taksat administrative dhe taksat për certifikatat e lindjes, martesës dhe vdekjes, që gjithsesi përbëjnë mjete simbolike në krahasim me shumat e planifikuara. Është interesante të përmendet që përveç komunës së Zveçanit,<sup>24</sup> asnjë komunë tjetër nuk ka bërë asnjë shpenzim nga kjo kategori buxhetore (të ardhurat vetanake).

<sup>19</sup> Rregullorja e Ministrisë së Financave nr. 03/2013 për raportet vjetore financiare të organizatave buxhetore, gjendet tek <http://bit.ly/2tyRoqg>

<sup>20</sup> Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur kushtetues, ndërsa më shumë për këtë institucion, në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe, shih <http://bit.ly/2uëVAqS>

<sup>21</sup> Raporti i auditimit të raporteve financiare vjetore të Komunës së Zveçanit për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016, qershor 2017, gjendet tek <http://bit.ly/2vcjPrE>

<sup>22</sup> Kjo gjetje e raportit të auditorit shkakton dyshime, sepse Komuna Zubin Potok ka të miratuar Strategjinë e Zhvillimit Komunal për periudhën 2013-2017, si dhe Strategjinë e zhvillimit të turizmit për periudhën 2015-2020, derisa Komuna e Leposaviqit gjithashtu ka Strategji të Zhvillimit të Turizmit për periudhën 2017-2022.

<sup>23</sup> Për shembull, gjatë vitit 2016, në komunën e Zveçanit janë shpenzuar në total 51% e buxhetit për investime kapitale

<sup>24</sup> Gjatë vitit 2016, komuna e Zveçanit nga kategoria e të ardhurave vetanake ka shpenzuar 6.342 Euro

#### 4. Konkludime

Ekzistojnë katër sfida kryesore me të cilat përballen komunat në veri të Kosovës, e që ndërlidhen me financimin e tyre. Sfida e parë ka të bëjë me pakënaqësinë e të gjitha komunave në veri të Kosovës me shumatat e buxheteve vjetore që janë caktuar nga Qeveria në Prishtinë, ku komunat insistojnë që atyre iu përket buxhet tejet më i madh sesa ai që është ndarë për to. Ky ka qenë problem sidomos gjatë vitit 2014, kur këto komuna për një kohë të gjatë nuk kanë dashur të pranojnë mjetet e ndara buxhetore.

Sfida e dytë ka të bëjë me kapacitetet e pamjaftueshme të komunave në realizim të mjeteve të ndara në kuadër të vitit fiskal. Realizimi i dobët i buxhetit posaçërisht vërehet në domenin e realizimit të projekteve kapitale, ku projektet shpesh barten nga viti fiskal në vitin tjetër, e për këtë duhet autorizim i veçantë i Ministrisë së Financave.

Sfida e tretë ka të bëjë me refuzimin e të gjitha komunave që të realizojnë mjete buxhetore në sektorin e arsimit dhe atë të shëndetësisë. Arsyeja për këtë qëndron tek fakti që këta dy sektorë janë paraparë të jenë nën kompetencat e Bashkësisë/Asociacionit të Komunave Serbe, kështu që me realizimin e mjeteve të disponueshme buxhetore në këto konsiderohet rrënim i iniciativës për formimin përfundimtar të Bashkësisë/Asociacionit.

Sfida e fundit ka të bëjë me refuzimin e komunave që të zbatojnë dispozitat e Ligjit për financat e pushtetit lokal në fushën e të ardhurave vetanake. Kështu, të ardhurat që komunat inkasojnë nga burimet vetanake janë të neglizhueshme, nën 10% të të ardhurave të parapara.

Në fund, mund të konkludohet që ekziston një trend pozitiv në procesin e financimit të komunave në veri të Kosovës në të gjitha çështjet, e sidomos ato që ndërlidhen me përfundimin e kapaciteteve lokale për ekzekutimin e mjeteve buxhetore.

*InTER – Instituti për Zhvillim Teritorial Ekonomik - është një think tank i pavarur jo qeveritarë me mision të promovimit dhe përparimit të zhvillimit territorial shoqëro-ekonomik në Ballkanin Perëndimorë.*

*Qyteti Verior, Çika Jovina pn, Mitrovicë Veriore  
office@regionalnirazvoj.org • www.regionalnirazvoj.org*

*Ky dokument për politika është shkruar në kuadër të projektit “Mbështetje qeverive lokale në veri të Kosovës në reformimin e administratës publike” të financuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, që realizohet nga Instituti për Zhvillim Ekonomik Teritorial (InTER). Projekti realizohet në periudhën maj 2016 – korrik 2017.*

